

**Informacion për prindërit për
shkollat dhe institucionet e
edukimit elementar(kopshtet dhe çerdhet)**

Ashtu siç është bërë e njohur edhe nga mediat, në Austri ka përsëri përhapje të fruthit e në më të shumtën e rasteve në Steiermark, por edhe në Kärnten dhe në Vjenë. Dëshirojmë t'iu japim disa informacione të rëndësishme rreth sëmundjes dhe procedurat administrative në rast të shpërthimit të saj në një institucion publik.

Simptomat dhe rrjedha e sëmundjes

Virusi i fruthit përhapet përmes spërklave të ajrit, pra gjatë të folurit, të kolliturit apo teshtitjes, por edhe përmes ajrit ose objekteve të kontaminuara.

98 nga 100 persona të pambrojtur, ata të cilët kanë patur kontakt me persona të infektuar, janë infektuar vetë me këtë virus.

Sëmundja fillon me simptoma të ngjashme me gripin dhe pas 3 deri 7 ditësh shfaqet skuqja e lëkurës. Direkt pas kësaj dhe për një kohë të gjatë imuniteti i trupit dobësohet shumë, përmes së cilës rritet rreziku i sëmundjeve të tjera dhe infekteve bakteriale.

Në 20 % të rasteve shfaqen komplikacione si infeksion në vesh ose infeksioni i mushkërive. Në raste të rrallë infeksioni në mushkëri apo në tru mund të çojë në dëmtime të përhershme.

Sidomos kur ka komplikacione të rënda ose në rastin e rrallë të SSPE (subakut skelorozi Panenzephalitis) virusi i fruthit mund të përfundojë edhe me vdekje.

Vetëm një mbulim vaksimimi i lartë i popullsisë prej 95 % mund ta ndalojë përhapjen e virusit.

Masat që duhen marrë

Nga autoritetet e administratës së rajonit duhet të kontrollohet tek personat që kanë patur kontakt mbrojtja nga fruthi dhe mbrojtja imunitare.

Për shkak se fruthi është sëmundje shumë ngjitëse, duhet të konsiderohen si persona kontakti të gjithë të pranishmit dhe të punësuarit në atë objekt(duke përfshirë kujdestarin e ndërtesës, nëpunësit civile, personeli ndihmës etj...)

Në bazë të dispozitave të ligjit për epideminë të gjithë personat të cilëve i mungon mbrojtja imunitare përjashtohen nga ana e autoriteteve deri në 21 ditë nga vizita e ambjenteve publike.

Këta janë personat që:

- **nuk e kanë kaluar sëmundjen e fruthit ose**
- **nuk mund të dëshmojnë dy vaksinat e fruthit**

Si të mbrojtur konsiderohen të gjithë personat, që para kontaktit kanë marrë **dy vaksinat e fruthit**(të dokumentuara në librezën e vaksinave), ose e kanë kaluar sëmundjen dhe këtë mund ta dëshmojnë nëpërmjet një konfirmimi mjeksor ose një titri të antittrupave.

Personave që kanë bërë vetëm një vaksinë vruthi u rekomandohet urgjentisht vaksina e dytë.

Vaksinimi është pa pagesë dhe mund të bëhet në Landin e Salzburgut në çdo moshë në vendet publike të vaksinimit ose tek mjekët.

Ju lutemi të kontrolloni tani në interesin tuaj librezën e vaksinave, nëse dhe sa vaksina të fruthit keni marrë ju dhe antarët e familjes suaj.

Vaksinat e përdorura më shpesh këtu janë M-M-RWAXPRO
(në të dyja rastet bëhet fjalë për një vaksinë të
kombinuar kundër shytave, fruthit dhe rubeolës).

Shumë faleminderit!